



Pranuar / Dorezuar Prilapeno / Predato Received / Delivered	05. 05 2021	1	viti god year
Organ / Shërbimi Organ / Sluzhba Org / Unit	No Prot Br Prot Prot No	Shtetpi a Protog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMBHCK	2203/2021		115



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.163/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2504/19 të datës 11.03.2021, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.461/2019 të datës 13.08.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Lagjja "Dragodan", Tregtia C-3, hyrja 6/nr.8, Komuna e Prishtinës, kundër Vendimit me Nr.prot:153 të datës 24.07.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 47 dhe nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 05.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.461/2019 e datës 13.08.2019 e parashtruar nga ankuesi
- II. **Anullohet** Vendimi me Nr. Prot:153 i datës 24.07.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave (KZKA) në Administratën Tatimore të Kosovës, dhe lënda **kthehet në rishqyrtim** të organi i njëjtë, KZKA.
- III. **Obligohet** Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për zbatim e këtij vendimi.
- VI. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Ar sy e t i m

Ankuesi i punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës, me datë 13.08.2019 ka parashtruar ankesën me numër protokoli 3542/2019 të regjistruar me numër A.nr.461/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.ref.11/153 të datës 24.07.2019 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Administratën Tatimore të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 16.08.2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Administratën Tatimore të Kosovës. Këshilli, me datë 23.08.2019 ka pranuar përgjigje në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Në mungesë të kuorumit për vendosje në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankuesi të njëjtën kohë, ka hapur konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 11.03.2021 ka nxjerr Aktgjykimin me numër A.nr.2504/19, përmes të cilit ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtoje dhe të vendos për ankesën e datës 13.08.2019 të parashtruar nga ankuesi

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 3542/2019 të regjistruar me numër A.nr.461/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopja e konkursit me nr.271 të datës 05.06.2019; Vendimin me Nr. prot:127 të datës 18.06.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës; Njoftimin numër protokoli 346 të datës 19.06.2019 për anulimin e konkursit; Vendimin me Nr.prot:09-06-2528 të datës 13.06.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së; Vendimin me Nr.prot:329 të datës 13.06.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së; Ankesën e datës 25.06.2019 të ankuesit të parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës; Vendimin me Nr.prot:153 të datës 24.07.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës; Kontratën e punës të datës 01.06.2000; Kontratën mbi marrëdhënien e punës me nr.02/578/09 të datës 15.06.2009; Vendimin me nr.66 të datës 21.02.2012; Akt Emërimit me nr.02/578/09 të datës 23.02.2012; Akt Emërimi me nr.27/579/09 të datës 28.02.2014; Akt Emërimi me nr.02/579/09 të datës 10.03.2016; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2008; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2015; E-mailin zyrtar të datës 07.06.2019; Kërkesë e datës 12.06.2019 përmes e-mailit zyrtar; E-mailin zyrtar të datës 16.01.2012; E-mailin zyrtar të datës 06.06.2019; Strukturën Organizative të Administratës Tatimore të Kosovës, të datës 10.05.2019; Projekt Rregullore Nr.ATK 13/2019 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Tatimore të Kosovës, me nr.09-06-2149 të datës 17.05.2019; ; E-mailin e datës 27.08.2019 nga A.B për T.M; E-mailin e datës 30.08.2019 nga T.M për A.B; Kontratën e punës së datës 25.02.2010 dhe

Përgjigje në ankesë të datës 23.08.2019, Aktgjykimin me numër A.nr.2504/19 të datës 11.03.2021.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e bazuar, dhe lënda duhet të kthehet në rishqyrtim, sepse:*

Bazuar në provat e administruara të lëndës, është konstatuar se ankuesi në kohën e paraqitjes së ankesës ka qenë i punësuar në pozitën e punës, Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm i Operacioneve në Administratën Tatimore të Kosovës.

Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, me datë 13.06.2019 ka nxjerr Vendimin me Nr.09-06-2528 përmes të cilit ka shfuqizuar akt emërimit të ankuesit për pozitën e punës Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm i Operacioneve, dhe përmes Vendimit Nr.392 të datës 13.06.2019, ankuesin e ka caktuar ushtrues të detyrës të Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të Operacioneve. I pakënaqur me vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së, ankuesi me datë 25.06.2019 ka parashtruar ankesën me numër protokoll 11-06-2680 në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në ATK. Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me datë 24.07.2019 ka nxjerr Vendimin me Nr.prot:153 përmes të cilit ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e ankuesit dhe ka lënë në fuqi Vendimin me Nr.09-06-2528 të datës 13.06.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së.

Kundër Vendimit me Nr.prot:153 të datës 24.07.2019 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave, ankuesi me datë 13.08.2019 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbirës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se veprimet e Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së, me rastin e shfuqizimit të akt emërimit për pozitën e punës Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm i Operacioneve, nuk janë në përputhje me ligjin sepse i njëjti ka tejkalluar kompetencat dhe autorizimet e lejuara me nenin 3 të Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Me tutje ankuesi pretendon se arsyetimi i Vendimit me Nr.prot:153 i datës 24.07.2019 i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës, i pakuptueshëm, dhe nuk përmban bazën ligjore si përgjigje në pretendimet e shumta të parashtruara në ankesë, dhe si i tille arsyetimi i këtij vendimi është i barabartë me mungesën e tij në kuptim të nenit 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit shqyrtoje vendimet e goditura, gjegjësisht Vendimin me Nr.09-06-2528 13.06.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-se, dhe Vendimin me Nr.prot:153 të datës 24.07.2019 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Administratës Tatimore të ATK-së, dhe si rrjedhojë konstatoje se vendimet janë juridikisht të paqarta dhe kundërthënëse me vetveten dhe me arsyetimin e tyre, sepse: Në arsyetimin e Vendimit me Nr.prot:153 të datës 24.07.2019 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave, thuhet se Komisioni konstaton se pozita e zëvendës drejtorëve të përgjithshëm janë të përcaktuara vetëm me ligjin e themelimit të Agjencise (jo me ligjin e Administratës shtetërore e as me Ligjin e Shërbimit Civil të Kosovës), dhe personat e emëruar në këto pozita nga Drejtori i Përgjithshëm, bazuar në kompetencat që ia

jep neni 3 paragrafi 3 nen paragrafi 3.5 i Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, të njëjtit duhet paraprakisht t'i nënshtrohen intervistës dhe procesit të emërimit sipas dispozitave të Shërbimit Civil të Kosovës, gjë e cila nuk ka ndodh dhe të njëjtit vetëm i është lëshuar akt emërimi në vitin 2016, pa ju nënshtruar kurrfarë procedure të rekrutimit apo avancimit. Mbi këtë bazë Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, konsideron se meqenëse pozita e zëvendës drejtoreshave të përgjithshëm të agjencioneve janë lenë në përgjegjësin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencioneve Ekzekutive që me ligj të Themelimit të Agjencionit të vendosin lidhur me emërimin e tyre, atëherë kohëzgjatja e atyre pozitave është e ndërlidhur me kohëzgjatjen (mandatin) e vet Drejtorit të Përgjithshëm të Institucionit. Ndërsa ky komision, me të njëjtin vendim konstaton se Ligji Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, i japin të drejtë Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së, për shfuqizimin e akt emërimit për pozitën e zëvendës drejtorit të përgjithshëm për operacione. Andaj, në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se arsyetimi i këtij vendimi është i paqartë, kundërthënës dhe i pakuptueshëm, për me tepër i njëjti nuk përmban përshkrimin e shkaqeve të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave dhe shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve, andaj si i tillë është në kundërshtim me nenin 48 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1, 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, bazuar në konstatimet si me lartë, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, vlerëson se pretendimi ankimor i ankuesit në kuptim të metave të aktit administrativ të goditur me ankesë, është i bazuar, kështu që në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi të aprovoje ankesën si të bazuar dhe të kthej lëndën në rishqyrtim në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Administratën Tatimore të Kosovës.

Kolegji, duke marr parasysh se kjo procedurë ankimore ka filluar në kohën kur ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe duke u mbështetur në nenin 83 paragrafi 9 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë, konstatoje se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, i themeluar sipas dispozitave të Ligjit për Shërbimin Civil, ka mandat ligjor për ri shqyrtimin e kësaj lënde, dhe i njëjti në procedure të rishqyrtimit duhet t'i eliminojë të metat e aktit administrativ të kontestuar dhe të veprojë në pikëpamje juridike të këtij vendimi, duke zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe të vendos lidhur me çështjen e ankuesit në përputhje me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Ligjin Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, si dhe legjislacionin tjetër përkatës të aplikueshëm në rastin konkret.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkrësive të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.163/2021

Avdyl Bekteshi



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

